



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM

Nr. 552, datë 25.11.2021

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Diamela Goxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çështjen penale me të pandehur: Të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Vrasje me dashje”, etj., parashikuar nga neni 76, 25, etj. të Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Nurjeta Tafa, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Zbatim marrëveshje”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Shpëtim Reka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 108/a/2, 286/2 dhe 130 të Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Artan Çupi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit”, në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 136/2 dhe 22 i Kodit Penal”, dërguar nga Prokuroria me objekt: “Dërgim çështje në gjykim, etj.”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Suela Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Neni 139 e 25 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Lutfije Celami, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje me dashje”, e kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 76, 25 e 22 i Kodit Penal”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Hazbi Balliu dhe Ema Shaholli, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen civile me Paditës: Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Detyrimi i palës së paditur për pagimin e shumës prej 7.920 (shtatë mijë e dyqind) euro sipas faturës tatimore shitjeje nr.16 të datës 04.04.2013, 25.820 (njëzet e pesë mijë e tetëqind e njëzet) euro sipas faturës tatimore shitjeje nr.27 të datës 30.05.2014 së bashku me kamatat e arrira deri në momentin e ekzekutimit të vendimit”.

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Adejalda Gjuzi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Nenet 283/a/1 e 22, 333/4/2 dhe 334/1 të Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 278/4 i Kodit Penal”

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Tonin Sterkaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Astrit Kalaja dhe Valbona Vata, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: Për veprën penale prashikuar nga nenet 248-25 dhe 186/3 të K.Penal.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Arta Duka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me Kallëzues: {...}; Të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Falsifikimi i dokumentave”; “Shpërdorim detyrë”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë, Dritan Hasani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Vrasje nga pakujdesia”; “Moskallëzim krimi”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Sonjela Voskopi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të akuzuar: {...}, {...}, {...}; Objekti: “Kërkohet deklarimi fajtor për kryerjen e veprës penale “Dëmtime të tjera me dashje”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Mashtrim”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja dhe Anita Mici, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 259, 248 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Irida Kacerja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 283/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni (relatore), Enton Dhimitri dhe Irena Brahimi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Sigurim padie”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë; I pandehur: {...}; Akuza: “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR